

# **Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë**

**Raporti i Auditimit të pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare  
2016**

## Përmbajtja

Raporti i Auditorit të Pavarur .....	1-2
Pasqyra e të ardhurave .....	3
Pasqyra e pozitës financiare.....	4-5
Pasqyra e ndrrimit në ekuitet.....	6
Pasqyra e rjdhës së parasë .....	7-8
Shpjegimet lidhur me të hyrat, shpenzimet, pasurit dhe detyrimet.....	9-11
Shënime mbi Qarkullimin dhe Përdorimin e Fondeve .....	12-19
Shkurtimet.....	20

# Raporti i Audituesit të pavarur mbi auditimin e pasqyrave financiare

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Kuvendit të anëtarëve

Sylejman Vokshi, Blloku B, Hyrja 2, Nr. 1

## Opinioni

Kemi audituar pasqyrat financiare të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2016, pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të organizatës me 31 dhjetor 2016, të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë dhe janë në pajtueshmëri me Ligjin Nr.04/L-57 Për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

## Baza për opinionin

Auditimin e kemi kry në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin epasqyrave financiare të këtij raporti*.

Jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtueshmëri me këto kërkesa dhe Kodin e IESBA.

Besojmë se evidanca e përftuar e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë të arsyeshme për opinion.

## Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të veçantë.

## Vijimësia

Pasqyrat financiare, janë përgatit mbi bazën e vijimësisë, drejtimi nuk ka për synim likuidimin as ndërprerjen e veprimtarisë së vetë për 12 muajt e ardhshëm.

Auditimi nuk ka identifikuar ekzistencën e ngjarjeve apo kushteve të cilat krijojnë dyshime mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi.

## Informacione të tjera të ndryshme nga Pasqyrat Financiare

Informacione tjera, financiare ose jo financiare që ndryshojnë nga pasqyrat financiare të audituara dhe raporti i audituesit mbi këto pasqyra, të përfshira në raportin vjetor të entitetit dhe kanë mospërputhje materiale me PF ose me njohjen e siguruar nga audituesi gjatë auditimit, ku çdonjëra prej tyre mund të dëmtojë besueshmërinë e PF dhe të raportit të audituesit mbi këto pasqyra, nuk janë identifikuar.

## Përgjegjësitë e drejtimi dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF dhe për kontrollin e tilla të cilat drejtimimendon se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.



Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse drejtimi ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprimit në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

### **Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garanci se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale në rast se ato ekzistojnë. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu jemi përgjegjës të:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontroleve.
- Përftojme njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga drejtimi.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e drejtitimit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfthuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjen nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrihet paraqitja e drejtë.

Kemi komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Prishtinë 23.06.2017.

Xhemail Sylja  
Auditor Ligjor  
Syl Hotla nr 1  
10000 Prishtinë  
044 156-921  
e-mail:xhemailsyla@gmail.com

*Xhemail Sylja*  
XHEMAIL SYLA  
Auditor Ligjor  
Statutory Auditor  
044/156 921, Prishtinë

## OJQ Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

### Pasqyra e të ardhurave

Për 01.01- 31.16.	Nota	Shpjegimi fq.	2016	2015
Në €.				
<b>Të hyrat</b>				
Të hyrat e shtyra në fillim të vitit			48,796	21,661
Kontributet	1	17	358,521	276,063
Të hyrat tjera			-	-
Të hyrat e shtyra në fund të vitit			125,891	91,478
<b>Totali I të hyrave</b>			<b>281,425</b>	<b>206,246</b>
<b>Shpenzimet operative dhe administrative</b>				
Projektet e realizuara	2	13	-	-
Shpenzimet administrative dhe personelit	3	16,17,19	281,425	206,246
Zhvierësimi/Amortizimi			-	-
<b>Totali i shpenzimeve</b>			<b>281,425</b>	<b>206,246</b>
<b>Mbetja/humbja operative</b>			-	-
Shpenzimet tjera			-	-
<b>Mbetja/humbja neto</b>			-	-

Shihe shpjegimet e bashkangjitura për pasurit dhe detyrimet

## OJQ Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

### Pasqyra e pozitës financiare

31.Dhjetor 2016

Në €	Nota	Shpjegimi fq.	2016	2015
<b>I Pasurit</b>				
<b>A. PASURIT AFATSHKURTRA</b>				
Paraja	4	17	129,728	120,825
Llogaritë e arkëtueshme		17	-	-
<b>Gjithësej pasurit afatshkurtra</b>			<b>129,728</b>	<b>120,825</b>
<b>B. PASURIT AFATGJATA:</b>				
Prona, pajisjet dhe impiantet		17	-	-
<b>Gjithësej pasurit afatgjata</b>			<b>-</b>	<b>-</b>
<b>GJITHËSEJ PASURIT:A+B</b>			<b>129,728</b>	<b>120,825</b>
<b>II DETYRIMET DHE EKUITETI</b>				
<b>A. DETYRIMET AFATSHKURTRA:</b>				
Llogaritë e pagueshme	6	19	127	27,076
Të hyrat e shtyra			125,891	91,478
Detyrimet rjedhëse	7		3,710	2,272
<b>Gjithësej detyrimet afatshkurtra:</b>			<b>129,728</b>	<b>120,826</b>

**B.DETYRIME AFATGJATA:**

Huazimet, Provisionet, tjera

**Gjithësejt detyrime afatgjata:**

-	-
-	-
<b>129,728</b>	<b>120,826</b>

**GJITHËSEJT DETYRIME: A+B****III EKUITETI**

Hapja fillestare

Të hyrat e shtyra

**GJITHËSEJ EKUITETI**

-	-
-	-
-	-
<b>129,728</b>	<b>120,826</b>

**GJITHËSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET**

Shihe shpjegimet e bashkangjitura për pasurit dhe detyrimet

Përfaqësues i autorizuar-Drejtor

Menaxher i Financave&amp;Burimeve njerëzore



## OJQ Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

**Pasqyra e ndrrimit në ekuitet**  
për vitin që përfundon më 31. Dhjetor 2016  
Në €

	<u>Kap.themeltar</u>	<u>Te hyrat e shtyra</u>	<u>Rezervat tjera</u>	<u>Gjithësei</u>
<b><u>GJENDJA MË 1 JANAR 2015</u></b>	-	-	-	-
Rritja-zvoglimi i të hyrave të shtyra				-
Diferencat nga përkthimet valutore		-		-
Dividendat				-
Deponimet e kapitalit shtesë				-
Ndarja e rezervave				-
<b><u>GJENDJA MË 31 DHJETOR 2015</u></b>	-	-	-	-
Rritja-zvoglimi i të hyrave të shtyra		-		-
Diferencat nga përkthimet valutore				-
Dividendat				-
Deponimet e kapitalit shtesë				-
Ndarja e rezervave				-
<b><u>GJENDJA MË 31 DHJETOR 2016</u></b>	-	-	-	-

Shihe shpjegimet e bashkangjitura për pasurit dhe detyrimet



# OJQ Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

## PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

01.JANAR &amp; 31.DHJETOR 2016

Në €

	2016	2015
<b>I RRJEDHA E PARSË NGA AKTIVITETET OPERATIVE:</b>		
Fitimi / (humbja) i / e vitit +/- e të hyrat e shtyra	34,414	69,817
<i>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave</i>		
Zhvlërësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	-	-
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	-	-
Amortizimi i pasurive të paprekshme	-	-
Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme	-	-
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese	-	-
Të ardhurat financiare MINUS	-	-
Shpenzimet financiare	-	-
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve +/-		
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>		
(Rritja)/zvogëlim në llog. e arkët.tregtare dhe të tjera	-	-
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe		-
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	-	-
Rritja/(zvogëlimi) në llog.e pagueshme tregtare dhe të tjera	(26,949)	27,076
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	1,438	
	-25,512	27,076
Tatimi në fitim i paguar	-	-
Interesi i paguar	-	-
<b>I RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIV. OPERATIVE</b>	<b>8,902</b>	<b>96,893</b>
<b>II RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVI.INVESTUESE</b>		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	-	-
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	-	-
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme	-	(999)
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme	-	-
Interesi i arkëtuar	-	-
Dividendat e arkëtuara	-	-
<b>II RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIVI.INVESTIESE</b>	<b>-</b>	<b>(999)</b>
<b>III RRJEDHA E PARASË NGA AKTIV.FINANCUESE:</b>		
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-

## OJQ Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Dividendat e paguara		
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë		
Ripagimi i kredive dhe huave		
Pagesat e lizingut financiar	-	
<b>III RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIV.FINANCUESE</b>	-	-
<b>RRITJA/(ZVOGLIMI)NETO I PARASË DHE EKVIVALENTËVE TË PARASË</b>	<b>8,902</b>	<b>95,894</b>
<b>PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË NË FILLIM TË VITIT</b>	<b>120,825</b>	<b>24,931</b>
<b>PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË NË FUND TË VITIT</b>	<b>129,728</b>	<b>120,825</b>

Shihe shpjegimet e bashkangjitura për pasurit dhe detyrimet

## Shpjegimet lidhur me të hyrat , shpenzimet, pasurit dhe detyrimet

	2016	2015
<b>1. Donacionet:</b>		
Beogradski Centar Za Bezbednost	25,375	
Centre Pour Le Controle Democratiqu	18,968	
CiviKos Social Foundation	36,000	
KFOS Grant E12/16	4,000	
Kirkon Ulkomaanapu SR	14,970	
Kosova Fondation For Open Social	5,000	
National Endowment For Democracy	44,109	
Norsk Utenrikspolistik Institut EUNPACK	34,641	
Open Society Institute	22,132	
Synyo GMBH	16,128	
The German Marshall Fund of the U.S.	17,510	
The Royal UNTD SRV INST FR DFNC ST	1,490	
U.S. Disbursing Officer Symbol 8769	118,198	
<b>Totali i Donacioneve:</b>	<b>358,521</b>	<b>276,063</b>
<b>2. Shpenzimet sipas programeve te realizuara:</b>		
	113,192	
	41,829	
	27,990	
	38,606	
	58,216	
<b>Totali i programeve të realizuara</b>	<b>279,833</b>	<b>-</b>
<b>3. Shpenzimet administrative dhe personelit</b>	<b>281,425</b>	<b>206,246</b>

10

**3/1 Personeli** 175,215 -  
Pagat 167,374 -  
Kontributi pensional 7,841 -

**3/2 Shpenzimet tjera operative**

Shpenzimet e furnizimit 97,219 -  
Shpenzimet per software 1,560  
Shpenzimet e telefonit fiks 826  
Shpenzimet per ngrohje 595  
Shpenzimet e transportimit- Huazim i vetures 823  
Shpenzimet e postes 505  
Shpenzimet e perikthimit 1,537  
Shpenzimet e provizioneve 7,352  
Shpenzimet e mirëmbajtjes 996  
Shpenzimet e mirëmbajtjes së Automjetit 786  
Shpenzimet e sigurimit te automjeteve 928  
Shpenzimet e qirasë 227  
Shpenzimet e telefonit mobil 7,313  
Shpenzimet e rrymes 1,706  
Shpenzimet e ujit 191  
Shpenzimet e mbeturinave 88  
Shpenzimet e udhëtimit 107  
Shpenzimet e kontabilitetit 8,307  
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar 1,100  
Shpenzime te ndryshme 219  
Shpenzimet e Derivateve 22,244  
Shpenzimet e Auditimit 1,806  
812



11

Shpenzimet per salla  
Verturat  
Sponsorimet  
Shpenzimet pa fature

2,786  
8,000  
26,084  
322

**3/3 Marketing, Ushqim, Akomodim**

8,991

Ushqim & freskim etj  
Akomodimi

4,717  
4,274

**4. Paraja**

RBKO  
Arka

31/12/2016 31/12/2015  
129,696.62 120,825.00  
30.96 -  
129,727.58 120,825.00

Totali i parasë:

**5. Pasurit dhe pajisjet**

	Kostoja e blerjes	Te reja	Shitur/Jasht përdorimit	Zhvlrësimi i akumuluar	Vlera neto në fund të vitit
Pajisjet kompjuterike					-
Pajisje për zyre					-
Mobile					-
Software dhe Sistemi					-
Veturat					-
Mjetet e pakapitalizueshme	-	-	-	-	-
<b>Totali:</b>	-	-	-	-	-

**6. Të pagueshmet**

Pastrimi  
KEDS  
Ujshjells  
Proconto

126.59  
7.59  
15.14  
3.86  
100.00

**7. Detyrimet afatshkurta**

Tatimet e pagueshme  
Kontributi i pagueshem

3,709.51  
1,631.85  
2,077.66

### Informata të përgjithshme dhe struktura qeverisëse

Sipas marrëveshjes së angazhimit, me Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), të pajisur me njohuri të mjaftueshme për fushën e afarizmit të OJQ-ve dhe fushave specifike siç janë tatimet, pagesat, kontabiliteti i OJQ-ve dhe menaxhimi i riskut, kemi bërë auditimin e raporteve financiare, për periudhën 01 Janar deri 31 dhjetor 2016, me standarde të larta profesionale të cilat nënkuptojnë por nuk kufizohen vetëm në testimin e transaksioneve dhe vlerësimin e ekzistencës, pronësisë dhe vlerësimin e pasurisë dhe detyrimeve.

QKSS është organizatë profesionale që ka për qëllim studimin, kërkimet shkencore, organizimin e konferencave dhe tryezave në sferën e politikave të sigurisë dhe mbrojtjes, të jetë zë i fuqishëm në drejtim të studimeve të sferës së sigurisë nga ana e institucioneve private, si një element shumë i rëndësishëm i kontrollit demokratik të mekanizmeve të sigurisë.

QKSS do të bëjë studime dhe kërkime shkencore gjithëpërfshirëse në sferën e politikave të sigurisë si në nivel lokal poashtu edhe në nivel rajonal e me gjere.

QKSS mund të bëjë studime dhe kërkime shkencore edhe në sferat tjera që në mënyrë të drejtperdrejte apo jo të drejtperdrejt lidhen me sferën e sigurisë.

Projektet e zhvilluara nga QKSS gjatë vitit 2016 ishin:

1. Barometri Kosovari i Sigurisë;
2. Matja e progresit, avokimi dhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve të sigurisë në Kosovë;
3. Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë;
4. Monitorimi dhe vlerësimi i integritetit në institucionet e sigurisë në Kosovë (2015-2018);
5. Qëllime të mira, rezultate të përziera; etj.

Selin e ka në Prishtinë, Rr. Nëna Terezë, Hotel Iliria nr.109. në Prishtinë.

Është regjistruar në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-57 "Liria e asociimit të OJQ-ve", si OJQ me Nr. 5111840-5, Numrin fiskal: 600278685;

Emri i plotë është: **Qendra Kosovare për studime të Sigurisë;**

Emri i shkurtë është: **QKSS**

### Qeverisja

Organi më i lart i qeverisjes është Kuvendi i Anëtarëve i cili e ushtron funksionin mes Bordit të QKSS i cili përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve. Përfaqësues i autorizuar në Kosovë dhe Drejtor i përgjithshëm është Florian Qehaja, me numër personal 1001434566;

## Objektivi dhe karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare

### Identifikimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare identifikohen qartë dhe dallohen nga informacionet tjera.

Emri i njësisë raportuese, njësia individuale që mbulohet, periudha e mbuluar, monedharaportuese dhe rrumbullakimi i shumave në mijra euro, janë paraqitë dukshëm dhe janë përsërit kur ishte e nevojshme për kuptim të saktë të informacionit të paraqitur.

Titujt e faqeve dhe titujt shkurtuar janë paraqitë në kolonat e çdo faqeje në pasqyrat financiare.

Pasqyrat financiare paraqesin efektet financiare të transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera duke i grupuar ato në klasa të gjëra sipas karakteristikave të tyre ekonomike.

Të gjitha zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë një periudhe janë përfshirë në fitim ose humbje.

Organizata nuk kap paraqitë si zëra të jashtëzakonshëm asnjë zë të të ardhurave ose shpenzimeve, as në pasqyrën e të ardhurave as në shënimet shpjeguese.

Zërat materiale të të ardhurave dhe shpenzimeve janë paraqitë ndaras për nga natyra dhe shuma.

Objektiva e PF është plotësuar pasi që japin informacione të mjaftueshme lidhur me gjendjen financiare, rezultatin financiar dhe ndryshimet e gjendjes financiare që janë të dobishme për përdoruesit në marrjen e vendimeve ekonomike, plotësojnë nevojat e shumicës së përdoruesve dhe pasqyrojnë kujdesin e treguar nga ana e drejtimit për burimet që i janë besuar.

Janë të kuptueshme për përdoruesit me njohuri të arsyeshme për organizatën, veprimtarin dhe kontabilitetin.

### Baza e përgatitjes së raporteve financiar

**Njohja-përfshirja** në bilancin e gjendjes ose në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të një transaksioni është bërë kur ka qenë reale se çdo përfitim ekonomik në të ardhmen që lidhet me këtë transaksion do të rrjedhë tek ose nga subjekti dhe transaksioni ka pas kosto ose vlerë që mund të matet me besueshmëri.

**Matja** është procesi i përcaktimit të shumave monetare me anë të të cilave do të njihen dhe barten në bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, elemente të pasqyrave financiare.

Kjo përfshin zgjedhjen e një baze të veçantë të vlerësimit.

Si bazë matëse të pozicioneve në PF është kostoja historike.

Pasuritë dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet janë raportuar ndaras.

### Klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve

Aktivet dhe detyrimet janë paraqitë sipas parimit afatshkurtër-afatgjatë;

Detyrimet e mbajtura për qëllime tregtimi janë klasifikuar si afatshkurtëra;

Detyrimi financiar që duhet të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve nga data e bilancit, për të cilin organizata nuk ka pas ndonjë të drejtë të pakushtëzuar për shtyrjen e shlyerjes së tij për të paktën dymbëdhjetë muaj nga data e bilancit, është klasifikuar si detyrim afatshkurtër.

### Kontabiliteti mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara

Organizata ka përgatitë pasqyrat financiare, duke përdorur kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

### Materialiteti dhe bashkimi



Mungesa ose deklarime të gabuara të zërave që janë materiale, (nëse në mënyrë individuale ose kolektive mund të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, vendime këto të marra në bazë të pasqyrave financiare), nuk ka patur.

Çdo klasë materiale e zërave të ngjashëm është paraqitur së bashkuar në pasqyrat financiare. Zërat që nuk janë të së njëjtës natyrë ose funksion janë paraqit ndaras me përjashtim të rastit nëse janë jo-materiale.

Zëri që nuk është individualisht material, është bashkuar me zëra të tjerë në pasqyrat përkatëse dhe është shqaruar në shënimet shpjeguese.

#### **Kompensimi**

Pasurit dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë kompenzuar me përjashtim kur kjo ishte kërkesë ose lejohej nga një Standard ose një Interpretim.

#### **Baza neto e raportimit**

Fitimet dhe humbjet që vijnë nga një grup transaksionesh të ngjashme raportohen mbi bazë neto, fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit ose fitimet dhe humbjet nga instrumentat financiarë të mbajtur për tregtim.

Megjithatë fitime dhe humbje të tilla kur janë material raportohen veçmas.

#### **Periudha raportuese dhe principi i krahasueshmërisë**

Raportet financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar si dhe me kërkesat e tjera për raportim të përcaktuara nga ligji.

Periudha raportuese përfshin periudhën dymbëdhjetë mujore duke përfunduar më 31 Dhjetor të çdo viti.

#### **Parimi i vazhdueshmërisë së afarizmit**

Raportet financiare janë përgatitur me supozimin se organizata ka aftësi dhe qëllim të vazhdojë dhe do të vazhdojë të funksionojë në një të ardhme të afërt dhe nuk ka ndërmend as nevojë të likuidojë ose të zvogëlojë materialisht shkallën e operacioneve të saja.

Mundësia e vazhimit të veprimtarisë së organizatës edhe për dymbëdhjetë muaj, në bazë të artikujve në dispozicion, projekteve aktive dhe planeve të drejtimit - nuk është vënë në pikëpyetje.

#### **Principi akrual (i momentit të paraqitjes së transaksionit)**

Raportet financiare janë të përgatitura sipas parimit akrual, kjo nënkupton që fondet janë njohur në momentin e pranimit, kurse shpenzimet janë njohur në momentin e ndodhjes, në shumicën e rasteve momenti i ndodhjes është identik me momentin e pagesës.

Parimi akrual bënë të mundshme që efektet e ndryshimeve, qoftë rritja apo zvogëlimi i pasurisë, të njihen që në momentin e shfaqjes së tyre, pavarësisht nga momenti hyrjes apo daljes së parasë.

#### **Personeli**

Personeli është me profesione të llojllojshme. Evidencat mbi personelin, si p.sh. diploma, vërtetimi i përshtatshmërisë penale, formulari i informimit për rregullat, politikat, sigurinë dhe praktikën e organizatës, kontratat e punësimit, CV-të dhe dokumentacioni tjetër personal, janë të arkivuara në regjistrator të veçantë në formë të rregullt.

Përmbushja e detyrimeve tatimore dhe evidencat mbi to janë të ndara.



## Përmbledhje e Politikave të Kontabilitetit

### Deklarata të rëndësishme mbi politikat e kontabilitetit

Politikat kontabël janë parimet bazë, marrëveshjet, rregullat dhe praktikat e veçanta të zbatuar nga organizata në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare.

Një ndryshim në vlerësimin kontabël është një rregullim i shumës së mbartur të një aktivi osedetyrimi, ose shumës së konsumit periodik të një aktivi, që vjen nga vlerësimi i gjendjes aktuale të aktivit dhe detyrimit, si dhe përfitimeve të ardhshme të pritshme dhe detyrimeve të lidhura me aktivin dhe detyrimin.

Ndryshimet në vlerësimet kontabël vijnë nga informacioni i ri apo zhvillimet e reja dhe nuk janë korigjime të gabimeve.

Politikat e kontabilitetit të përshkruara janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

Në mungesë të një Standardi ose një Interpretimi që zbatohet veçanërisht për një transaksion, ngjarje apo kusht tjetër, drejtimi ka përdorë gjykimin e tij në zhvillimin dhe zbatimin e politikës kontabël që ka rezultuar në informacionin i cili është i besueshëm.

Për të përmbushur detyrimet e kërkuara nga Standardet e Kontabilitetit, "QKSS", ka vlerësuar se nuk është e nevojshme që të shpalos informacionet për të gjitha kërkesat.

Subjekti mund të jap informacione shtesë nëse përputhja me ndonjë kërkesë specifike të Standardeve të Kontabilitetit është e pamjaftueshme.

Nuk ka pasur ndryshime në vlerësimet kontabël që përfaqëson një rregullim në lidhje me rritjen e një aktivi ose pasivi që paraqitet si rezultat i një informacioni të ri apo zhvillimeve të reja që nuk janë korigjime të gabimeve.

Organizata, në rast nevojë, jep informacione shpjeguese për natyrën dhe shumën e ndryshimit në vlerësimin kontabël që ka efekte në periudhën aktuale apo kur pritet të ketë efekt në periudhat e ardhshme, përveç rastit të dhënies së informacionit shpjegues të efektit për periudhat e ardhshme kur është i pazbatueshëm vlerësimi i këtij efekti.

Organizata ka të angazhuar profesionist të kontabilitetit për udhëheqjen e evidencave në formë profesionale, e kjo ul rrezikun e auditimit dhe mundëson zbatim të procedurave të mostrimit gjatë auditimit.

### Llogaritë e Arkëtueshme

Debitorët janë të regjistruar në bilancin e gjendjes për shumat e caktuara.

Nuk kaprovizione të ndara për kërkesat e dyshimta sepse të gjitha llogaritë e arkëtueshme pritet të pranohen plotësisht.

QKSS nuk ka prezantuar llogaritë arkëtueshme në PF.

### Pasuritë

Në pasqyren e pozitës financiare nuk janë paraqitur shuma të pasurive të çfardolloji, pasi që ato në momentin e blerjes trajtohen si shpenzime të periudhës.

### Paraja dhe ekuivalentët e saj

Krijohen nga hyrjet e parave të gatshme dhe ekuivalentët e parave të gatshme.

Paraja e disponueshme është paraqitur në vlera reale në moment, duke filluar nga prania fizike në arkë dhe ato në llogarit bankare.

16

QKSS ka llogari bankare në RBKOPrishtina.

Pagesat dhe pranimet bëhen në këto llogari dhe për shuma të vogla me para në dorë.

Bilanci përmbyllës i mjeteve në llogaritë bankare të RBKODhe arkë ( Fq.11 e shënimeve) janë konfirmuar nga Pasqyra bankare, konfirmimi nga bankat si dhe nga Ditari i arkës i 31.12.2016.

**Transaksionet në valutë të huaj, risku i valutës**

Transaksionet në valutë të huaj, konvertohen në €, me normën e vlefshme të këmbimit në datën e transaksionit, ashtu që dallimet në këmbim, qoftë përfitim apo humbje, njihen automatikisht në pasqyrën e të ardhurave. Në fund të periudhës, zërat në valuta të huaja, raportohen duke përdor kursin e këmbimit të ditës së fundit.

Të ardhurat e organizatës dhe të gjitha raportet financiare të lëshuara shprehen në €.

Rreziku i valutës përfaqëson rrezikun që vlera e drejtpërdrejt ose rrjedha e parasë apo ndonjë pasuri monetare në të ardhshmen do të ndryshojë për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit.

Çdo diferencë këmbimi që rrjedh nga njohja e një zëri monetar me një kurs të ndryshëm nga ai me të cilin është njohur fillimisht gjatë periudhës, ose është njohur në pasqyrat financiare të mëparshme, njihet në fitim ose humbje.

Raste të tilla nuk janë evidentuar.

**Rreziku i Likuiditetit**

Rreziku që një entitet do të ndeshë vështirësi në shlyerjen e obligimeve që kanë të bëjnë me detyrimet financiare të cilat vijnë për shkak të mundësisë (e cila shpesh mund të jetë e largët) që një entitet mund t'i kërkojë të paguajë detyrimet e tij më herët sesa është pritur.

Pasurit afatshkurtra janë të barabarta me detyrimet afatshkurta.

**Kontributet**

E ardhura është njoh në pasqyrën e të ardhurave kur është kriju një rritje në përfitimet ekonomike që lidhet me një rritje të një aktivi ose një ulje të një detyrimi dhe kur kjo ka mundur të matet me besueshmëri. Njohja e të ardhurës ka ndodh njëkohësisht me njohjen e rritjes në aktivet ose uljes në detyrimet.

Kontributet janë të shprehura në vlerën e tyre të drejtë, ato janë të vlerësuara drejtë sipas pagesës së marrë apo që do të merret duke marrë parasysh ndonjë zbritje apo shumë të lejuar të reduktimit.

Kontributet njihen në momentin e dhurimit ose pagesës e cila është e bazuar në shumën reale të parasë të pranuar në bankë ose në arkë.

**Shpenzimet**

Shpenzimet jan njoh në pasqyrën e shpenzimeve kur është kriju ulje në përfitimet ekonomike që lidhet me ulje të një aktivi ose rritje të një detyrimi dhe kur ka pas mundësi të matet me besueshmëri.

Shpenzimet grupohen në pasqyrën e të ardhurave sipas funksionit të tyre. Njohja e shpenzimeve ka ndodh njëkohësisht me njohjen e një rritje në detyrimet ose me një ulje në aktivet.

Shpenzimet njihen në periudhën që i takojnë, gjatë kohës që ka ndodhur, dhe kjo varet nga njohja e shpenzimeve të caktuara.

Shpenzimet njihen me kostot e tyre historike, ato janë të shprehura në shumën reale kur shpenzimet kanë ndodhur.

Shpenzimet janë në nivelin e çmimeve të tregut.



Shpenzimet janë të mbështetura me dokumentacion origjinal siç janë fletëpranimet, faturat, kontratat, listë-pagesat dhe pasqyra bankare.

#### **Shpenzimet Administrative**

Shpenzimet administrative përfshijnë kostot e menaxhimit të punës, përmes shërbimeve ekzekutive, kostove financiare dhe administrative, duke përfshirë shpenzimet e shkaktuara si rezultat i punës normale në zyrë në mënyrë që të realizohen qëllimet helbësore të organizatës.

Shpenzimet administrative përbëjnë 38% të totalit të shpenzimeve

#### **E personelit**

Kostoja e personelit u është paguar të punësuarve të cilët janë angazhuar në kryerjen e detyrave të parapara me plan. Pagesat janë kryepërmes llogaris bankare me transfere, pasi që kanë nënshkruar listën e pagave dhe kanë paraqitë evidencat mbi kohën e angazhimit.

Përbëjnë 62% të shpenzimeve administrative

#### **Kontributi pensional, përfitimet e të punësuarve**

Pensionet janë kalkuluar sipas ligjit të aplikueshëm mbi pensionet. 5% janë paguar nga i punësuarit dhe 5% nga organizata. Afatet e pagesave dhe raportimit janë respektuar.

Organizata nuk ka Fond pensional të vetin as mundësi të pagesave në formë të aksioneve, për të punësuarit, në këtë bazë nuk ka detyrime të identifikuar më 31.12.

#### **Tatimi në paga**

Tatimi në paga është mbajtur në burim dhe paguar në afatet e caktuara, sipas shkallëve ligjore.

#### **Shpenzimet programore**

Kostoja e programeve është mbështetur me fatura të furnitorëve. Pagesa është e mbështetur me fatura dhe pasqyra bankare apo dokument të arkës për pagesat me të gatshme.

Programet e zhvilluara gjatë vitit janë të paraqitura në Fq.9 të raportit dhe janë të ri apo vazhdimësi e atyre të filluar në vitin e kaluar.

Shpenzimet Programore përbëjnë 99% të shpenzimeve totale të bëra gjatë kësaj periudhe.

#### **Shpenzimet e Qirasë**

Këto kosto janë përfaqësuar nëpërmjet shpenzimeve për marrjen e zyrës dhe sallave të konferencave.

#### **Shpenzimet e Mirëmbajtjes**

Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave në kohën e shfaqjes dhe përfshijnë shpenzimet e bëra për mirëmbajtjen e zyrës, pajisjeve dhe automjeteve.

#### **Detyrimet-Llogaritë e pagueshme**

Llogaritë e pagueshme janë njohurkur përcaktohet shuma korrekte dhe detyrimi që duhet paguar është rezultat i aktiviteteve të rregullta të organizatës. Per vitin 2016 paraqesin obligimet ndaj komunalive dhe shërbimeve të kontabilitetit të muajit dhjetor.

Detyrimet për vitin 2016 paraqesin tatimet e mbajtura në burim për pagesat e paguara për muajin dhjetor 2016.

#### **Tatimimet (mbajtja në burim)**

Organizata jo-qeveritare, jo-fitimprurëse, e regjistruar sipas Ligjit (No.04/L-57) "Mbi Lirinë e asociimit në Organizatat Joqeveritare", i nënshtrohet "Tatimit në të Ardhurat Personale në Kosovë" (Ligji 05/L-028). Organizata gjithashtu respekton Ligjin (L-03/L-084), "Mbi pensionet në Kosovë", llogarit dhe paguan kontributet për financimin e pensioneve individuale për punonjësit lokal.

"QKSS" nuk konsiderohet obligues për të paguar Tatimet mbi të Ardhurat e Korporatave sipas Ligjit (L-05/L-029) pasi që nuk realizon të ardhura nga veprimtaria komerciale. Organizata respekton dhe përmbushdetyrimin e Ligjit nr.05/L-028 për mbajtjen e 9% ngaqiraja bruto në kohën e pagesës dhe transferon në llogarinë e caktuar.

#### Palët e ndërlidhura

Si transaksion me palët e ndërlidhura ku një palë ka mundësin e kontrollimit të palës tjetër ose ka ndikim të rëndësishëm në palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe biznesore përtransferte kërkesave dhe obligimeve (kredive, kontratave afariste me punëtorë dhe biznese të ndërlidhura me drejtorin ose me ndonjë pronësi të përbashkët), nuk janë evidentuar.

#### Huazimet

Huat njihen me vlerën e tyre nominale plus shpenzimet shoqëruese si tarifat, skontot e mundshme dhe shpenzimet tjera lidhur me huan. Huat që janë të shprehura në monedha të ndryshme nga € regjistrohen me kursin historik dhe rivlerësohen me kursin e fundit të vitit-datën e raportimit.

Diferencat e këmbimit pasqyrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve qoftë si përfitim apo humbje.

Kostot e huazimit njihen si shpenzim i periudhës në të cilën ajo është krijuar.

Shpenzimet e interesit regjistrohen në bazë të metodës së interesit efektiv dhe janë përfshirë nëshpenzimet financiare.

Huat e pagueshme janë detyrime financiare, të ndryshme nga të pagueshmet tregtare afatshkurtra me kushte normale (të zakonshme) të kredisë.

Subjekti nuk ka pasur huazime gjatë vitit, si pasojë nuk ka kostot të huamarrjes gjatë kësaj periudhe.

#### Provizionet dhe detyrimet e shtyra

Donacionet e pashfrytëzuara-të hyrat e shtyra nga viti 2015 (21,661€) në vitin 2016. u trajtuan si shtesë e të hyrave të vitit në fillim të vitit, kurse ato të vitit 2016. (125,891€) janë treguar si të hyratë shtyra në fund të vitit dhe u zbritën nga të hyrat e vitit.

#### Rezervat

Organizata nuk ka mbledhur rezerva gjatë kësaj periudhe.

#### Dividentat

Organizata si OJQ, humanitare, jofitimprurëse, nuk ka deklaruar shumatë dividendëve të njohurësi shpërndarje neto gjatë periudhës dhe vlerën përkatëse për aksion.

#### Zotimet

Nuk ka zotime që lidhen me shpenzimet kapitale, lisingun financiar ose operativ.

#### Pasurit dhe obligimet kontingjente

Nuk ka raste të evidentuara të gjykatës ose depozite lidhur me organizatën, drejtorët ose punëtorët e saj që mund të rezultojë me detyrime të ardhshme të organizatës.



Ngjarjet pas datës së bilancit

Ngjarjet pas datës së bilancit të gjendjes përfshijnë të gjitha ngjarjet deri në datën e autorizimit të pasqyrave financiare për publikim.

Nuk kemi të shënuar ngjarje pas datës së bilancit e cila ka rëndësi dhe ndikim te përdoruesit dhe e cila duhet shpalosur.

## SHKURTIMET

QKSS Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

OJQ Organizatë Joqeveritare

PF Pasqyra Financiare ( Bilanci i gjendjes, Pasqyra e të ardhurave, Pasqura e ndrrimit të ekuitetit, Pasqyra e rrjedhës së parasdhe Shenimet shqaruese)

PA Pasqyra e të Ardhurave

BGJ Bilanci i Gjendjes

EUR Euro

ATK Administrata Tatimore e Kosovës

NF Numri Fiskal

MSHP Ministria e Shërbimeve Publike

SNK Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit